



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.26**

**15 mars**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.106, datë 28.2.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar.....	475
Vendim i KM nr.108, datë 28.2.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.....	476
Vendim i KM nr.111, datë 9.3.2007	Për krijimin e grupeve të punës për identifikimin dhe dhënien me koncesion .....	478
Vendim i KM nr.112, datë 21.2.2007	Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.....	479
Vendim i ERE nr.12, datë 28.2.2007	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit, për vitin 2007, për operatorët e licencuar.....	480
Vendim i ERE nr.13, datë 5.3.2007	Për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë me koncesion.....	481

Vendim i ERE nr.14, datë 5.3.2007	Për fillimin e procedurës së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë me koncesion, për vitin 2007.	482
Vendim i ERE nr.15, datë 5.3.2007	Për transferimin e licencës nga shoqëria “Emikel 2003” sh.p.k. te shoqëria “Emikel” sh.p.k.....	482

**VENDIM**  
**Nr.106, datë 28.2.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË**  
**PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË**  
**SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Në nënndarjen 19, te kreu 1.1 shtohet emërtesa “Kryeinfermier reparti në infektiv”.

b) Kreu 1.2 i lidhjes 1 zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër, emërtim dhe përmbajtje, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2007.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja 1 (kreu 1.2)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË**  
**E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE**

NR.	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	15500		Nga...deri lekë
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermiore		2%	0	14000		Nga...deri lekë
3	Infermier statistike		2%	0	12150		

**VENDIM**  
**Nr.108, datë 28.2.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË  
PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË  
SHËNDETËSISË, DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN  
E MINISTRISË SË MBROJTJES, SI DHE PËR TRAJTIMIN E MJEKËVE NË  
STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Kreu 1.3 zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Kreu 1.5 zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2007.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja 1 (kreu 1.3)

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË DREJTORITË E  
KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR DHE SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR  
PARËSOR, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS**

NR.	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
		1	2	3	4	5	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
1.	Drejtor dhe kryeinspektor sanitar	10050	2%	0	37000	9000	Nga deri...lekë
2.	Drejtor ekzekutiv	10050	2%	0	37000		Nga deri...lekë
3.	Drejtor	10050	2%	0	25000		Nga deri...lekë
4.	Shef shërbimi i	10050	2%	0	18000		Nga

	kujdesit parësor; Shef shërbimi urgjence; Zëvendës drejtor						deri...lekë
5.	Shef shërbimi i higjienës; Shef shërbimi i epidemiologjisë	10050	2%	0	18000	9000	Nga deri...lekë
6.	Shef shërbimi stomatologjik	10050	2%	0	18000	3300	Nga deri...lekë
7.	Specialist i lartë në higjienë; Specialist i lartë në epidemiologji	10050	2%	0	16150	7000	Nga deri...lekë
8.	Shef reparti; Përgjegjës poliklinike; Shef kabineti; Shef/përgjegjës laboratori; Përgjegjës dispancerie	10050	2%	0	16150		Nga deri...lekë
9.	Epidemiolog; Higjienist	10050	2%	0	16150	8000	Nga deri...lekë
10.	Inspektor stomatolog	10050	2%	0	16150	1100	Nga deri...lekë
11.	Shef reparti higjiene; Shef reparti epidemiologjie	10050	2%	0	16150	9000	Nga deri...lekë
12.	Mjek; Stomatolog; Inxhinier elektrik; Kimist; Veteriner; Mikrobiolog; Shef sektori; Përgjegjës zyre	10050	2%	0	13800		Nga deri...lekë
13.	Mjek ftizioterapeut; Mjek kirurg; Mjek ortoped; Mjek pneumoftiziatër	10050	2%	0	13800	1100	Nga deri...lekë
14.	Mjek radiolog; Mjek psikiatër; Mjek hematolog; Mjek onkolog	10050	2%	0	13800	1600	Nga deri...lekë
15.	Specialist i lartë	10050	2%	0	12000		Nga deri...lekë
16.	Specialist i lartë promocioni	10050	2%	0	12000	6000	Nga deri...lekë

**STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN  
KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË BARNAVE**

NR.	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1.	Drejtor	10050	2%	0	59714		Nga deri...lekë
2.	Zëvendësdrejtor	10050	2%	0	49942		Nga deri...lekë
3.	Shef sektori	10050	2%	0	43428		Nga deri...lekë
3.1.	Shef sektori	10050	2%	0	32571		Nga deri...lekë
4.	Farmacist	10050	2%	0	21714	4000	Nga deri...lekë
5.	Analist	10050	2%	0	32571	4000	Nga deri...lekë
6.	Farmacist inspektor për kontrollin farmaceutik	10050	2%	0	32571	5000	Nga deri...lekë
7.	Specialist i lartë	10050	2%	0	16286		Nga deri...lekë

**VENDIM  
Nr.111, datë 9.3.2007**

**PËR KRIJIMIN E GRUPEVE TË PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN DHE DHËNIEN ME  
KONCESION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e grupeve të punës për identifikimin dhe dhënien me koncesion, të cilat do të funksionojnë deri në krijimin e Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve, por jo më shumë se gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Objekti i veprimtarisë dhe përbërja e çdo grupi pune përcaktohen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Anëtarët, në përbërje të grupeve të punës, shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë)

lekë në muaj.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 mars 2007.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

## VENDIM

**Nr.112, datë 21.2.2007**

### **PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, shkronjat “ç”, “d” e “e”, dhe 7 shkronja “a”, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë me vlerë, për vitin 2007, prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh.

2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, deri në 1 000 000 (një milion) lekë, por në asnjë rast më shumë se 50 për qind të vlerës së kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshijnë kostot për:

a) investime, të prekshme dhe të paprekshme, në formën e përmirësimeve teknologjike, për përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të cilësisë;

b) shërbime këshillimore, në formën e studimeve të tregut dhe të trajnimeve;

c) pjesëmarrje, për herë të parë, në një panair ose ekspozitë jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) prodhojnë produkte ose ofrojnë shërbime, që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar dhe që, gjatë procesit, i japin një vlerë të shtuar, të konsiderueshme produktit përfundimtar;

b) kanë një strategji dhe plan marketingu për zgjerimin e ekspertëve;

c) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij.

4. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

5. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë fillon të zbatohet në vitin 2007 dhe zgjat për një periudhë 3-vjeçare.

6. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (ALBINVEST) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.

Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i

Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila do të krijojë një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të ALBINVEST-it.

8. Për vitin 2007, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kalojë për institucionin e varësisë, ALBINVEST, shumën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, në nënzërin “Fondi i konkurrueshmërisë”, i cili zëvendëson nënzërin “Studime në fushën e investimeve” të zërit “Mbështetje për zhvillim ekonomik”.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.12, datë 28.2.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2007**  
**PËR OPERATORËT E LICENCUAR**

Në zbatim të neneve 9 dhe 12, pikat 1, 3, 4, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Administrimit, Financës, Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arshivës, Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve, si dhe Departamenti i Licencimit dhe i Monitorimit, për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2007 për operatorët e licencuar,

**VENDOSI:**

1. Pagesat e rregullimit për operatorët e licencuar për vitin 2007 të jenë sipas tabelës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**TABELA E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2007**  
**PËR OPERATORËT E LICENCUAR**

Nr.	Kompania	Pagesa e rregullimit për vitin 2007 (në lekë)
1	ESSEGEI sh.p.k.	257,600
2	HYDROELECTRIC COMPANY OF ALBANIA sh.p.k.	110,600
3	EMIKEL sh.p.k.	22,100
4	AMAL sh.p.k.	5,100
5	SPAHIU-GJANÇ sh.p.k.	55,400
6	WONDER-POWER sh.a.	56,700



7	PROJEKSION sh.p.k.	1,000
8	SAROLLI sh.p.k.	1,000
9	JUANA sh.p.k.	2,300
10.	WTS Energji sh.p.k.	6,800
11	MARJAKAJ sh.p.k.	2,300
12	MAKSI sh.p.k.	5,400
13	DARDANIA sh.p.k.	1,000
14	FAVINA 1 sh.p.k.	29,700
15	ENERGO SAS sh.p.k.	1,000
16	GSA sh.p.k.	751,000
17	DARFO	50,500
18	OST sh.a.	2,180,000
19	KESH sh.a.	42,160,500
	Shuma për ERE	45,700,000

**VENDIM**  
**Nr.13, datë 5.3.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË  
PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT UNIK TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA  
HEC-ET E RINJ, ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW, TË DHËNË  
ME KONCESION**

Në mbështetje të neneve 26 pika 1 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” kreu IV pika 1“a” të këtyre rregullave dhe nenit 11 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.3.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për metodën e përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri më 10 MW, të dhënë me koncesion.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**  
**Nr.14, datë 5.3.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT UNIK TË ENERGISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA HEC-ET E RINJ, ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW, TË DHËNË ME KONCESION, PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të neneve 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” kreu IV pika 1 “a” të këtyre rregullave, nenit 11 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.3.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë me koncesion, për vitin 2007,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë në koncesion për vitin 2007.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Bujar Nepravishta

**VENDIM**  
**Nr.15, datë 5.3.2007**

**PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA “EMIKEL 2003” SHPK  
TE SHOQËRIA “EMIKEL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.37, datë 9.7.2004 “Për ndërtimin, instalimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike” pika 1.4, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.6, datë 16.2.2006 “Miratimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë “Emikel 2003” sh.p.k., Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 5.3.2007, pasi verifikoi proceset ligjore të shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k.,

**VENDOSI:**

- Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.6, datë 16.2.2006 “Miratimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë “Emikel 2003” sh.p.k”.

- Licenca e miratuar me vendimin nr.6, datë 16.2.2006 për shoqërinë “Emikel 2003” sh.p.k. për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Lenie (Gramsh), Çorovodë (Skrapar) dhe Tuçep (Bulqizë) t’i transferohet shoqërisë “Emikel” sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Bujar Nepravishta

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
  1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500
  2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ..... 600
  3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300
  4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500

### **Botime të reja**

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500

Hyri në shtyp më 13.3.2007  
 Doli nga shtypi më 15.3.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Grafon”  
 Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë